

UDHËZIM
Nr. 9, datë 24.1.2025

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 8, DATË 13.3.2017, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 9, pika 4 dhe nenit 10, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 18, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 9 dhe 10, të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” dhe urdhrit nr. 113, datë 26.3.2024 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Ana Kapaj”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 8, datë 13.3.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Shkronja “b” e pikës 4 ndryshon si më poshtë:

“b) Pranon aplikimet dhe bën njohjen dhe njësimin e diplomave të arsimit të mesëm të lartë, të nxënësve të ardhur nga jashtë vendit, sipas përcaktimeve në udhëzimin përkatës në fuqi. QSHA-ja administron dokumentacionin e këtij procesi në bazë të përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.”

b) Shkronja “c” e pikës 4 ndryshon si më poshtë:

“c) Pranon aplikimet dhe bën njohjen dhe njësimin e diplomave dhe certifikatave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, si dhe pranon aplikimet dhe koordinon procesin e shqyrtimit, lidhur me procedurat e njohjes së gradave dhe titujve akademikë të lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit. QSHA-ja administron dokumentacionin e këtij procesi, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.”

c) Pika 11 ndryshon si më poshtë:

“11. QSHA-ja drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili mbështetet nga 2 (dy) zëvendës drejtorë të përgjithshëm, të cilët emërohen me të njëjtat procedura si drejtori i përgjithshëm.”

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit, njësitë arsimore vendore, urdhrat profesionalë dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Ana Kapaj